

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“L&G Group Sh.P.K.”

Sot në datën 02.03.2021, ditë e martë, Unë ortaku i vetëm themelues, si më poshtë identifikohem:

- 1) **Z. Luan Xhixha**, i biri i Vath -it, shtetas shqiptar, lindur në Likmetaj më 13.11.1968, banues në Likmetaj; Nd. 097; H. 00; Ap. 000; Ishëm; Likmetaj; 2015; Durrës, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. BR2320612, lëshuar më datë 20.11.2019, datë skadence 19.11.2029, identifikuar në regjistart e Gjendjes Civile me nr. personal G81113108Q;

Hartoj Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar si më poshtë:

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet **“L&G Group Sh.P.K.”**, dhe është person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve të këtij statusi dhe ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si edhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” dhe akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në do të ketë selinë e saj në Durrës, Lalëz, Kompleksi Lura, shkalla nr. 2, ap. nr. 37, me nr.pasurie 169/32+1-9, vol. nr. 12, faqe nr. 181, zona kadastrale 2375.

Shoqëria mund të krijojë Filiale, Zyra Përfaqësimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë si **objekt të veprimtarisë së saj** :

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj kryesisht në sektorin e ndërtimit të pasurive të paluajtshme, shitjes së pasurive të paluajtshme, brënda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, tregtimit dhe dhënies me qira të pasurive të paluajtshme brënda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, për t'i ofruar shërbime të ndryshme në lidhje me tregun e pasurive të paluajtshme dhe qarkullimin civil të tyre, pa u kufizuar, të gjithë individëve, të gjithë njësive ekonomike të vendosura dhe që operojnë në Republikën e Shqipërisë, por edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë institucionet publike dhe enteve, personave juridik publik apo privat, pavarësisht nga forma e e organizimit të tyre juridik por edhe njësive të tjera, pavarësisht nëse janë subjekte fitimprurëse apo jo fitimprurëse në përputhje me legjislacionin e zbatueshem mbi këtë veprimtari; do të ushtrojë veprimtarinë e saj edhe në tregtimin pasurive të luajtshme, tregtimin e mallarave të ndryshme në të gjitha mënyrat dhe format që legjislacioni lejon; gjithashtu do të ushtrojë veprimtarinë e saj edhe sektorin e punësimeve në sektorin privat të individëve apo subjekteve të huaj në tregun shqiptar por edhe individëve apo subjekteve shqiptarë në tregun e huaj dhe konkretisht, kryesisht në këto fusha:



- Fushën e tregtimit të pasurive të paluajtshme në tregun shqiptar dhe të huaj në të gjitha format që legjislacioni shqiptar parashikon.
- Fushën e ndërtimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme pa asnjë kufizim.
- Fushën e shërbimeve komisionere;
- Fushën e punësimit të individëve apo subjekteve private vendase dhe të huaja në tregun shqiptar dhe të huaj.
- Fushën e investime në sektorin e ndërtimit dhe në të gjithë sektorët e lejuar nga ligji.
- Fushën e import-eksport të të gjitha produkteve, të makinerive industriale, makinerive bujqesore etj., agregateve dhe pjeseve te tyre te kembimit, te reja dhe te perdorura.
- Fushën e tregtimit me pakicë dhe shumicë të të gjitha mallrave të konsumit, të makinerive industriale dhe makinerive te nevojshme ne të gjithë sektorët, të reja dhe të përdorura, të pjesëve të këmbimit për këto makineri, të reja dhe të përdorura,;
- Import-eksport dhe tregtim të të gjitha mallrave në qarkullim civil.
- Realizimi, studime fizibiliteti, ndertim, menaxhim, planifikim, blerje, shitje, marketing dhe mirembajtjen e makinerive dhe paisjeve industriale.
- Ndertimin dhe shfrytëzimin e impianteve në sektorin e industrisë;
- Import – Eksport te produkteve te tjera ushqimore dhe mallrave te konsumit.
- Tregtimin me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore dhe mallrave te konsumit.
- Shitje, Qiradhenie etj., te pasurive te luajtshme dhe te pasurive te paluajtshme.
- Asistence per mirembajtjen dhe riparimin e makinerive industriale dhe çdo makinerie per klientet e ndryshem.
- Gjithashtu në dhënien e konsulencës për të gjithë subjektet që operojnë në tregun shqiptar dhe të huaj në të gjitha fushat e specifikuar më sipër.

NENI 4 **KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërise “L&G Group Sh.P.K.”, është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital **është i ndarë në 1 (një) kuotë.**

Pjesëmarrja e themeluesve/ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre dhe do të shpërndahet si më poshtë:


1. **Z. Luan Xhixha**, zotërues i **një (1) kuote** që përkon me **100 %** të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 100.000 Leke.

NENI 5 **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Kompania do të kryejë aktivitetet e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6 **ORGANET E SHOQËRISË**

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve



2. Administratorët

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerine për çështjet e mëposhtme:

1. Percaktimin e politikave tregtare të shoqerise.
2. Ndryshimin e statutit.
3. Emerimin dhe shkarkimin e administatoreve.
4. Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar.
5. Percaktimin e shperblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
6. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët ,përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportve të ecurise së veprimtarise.
7. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
8. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
9. Perfaqesimin e shoqerise në gjykate dhe në procedimet e tjara ndaj administatoreve.
10. Riorganizimi dhe prishjen e shoqerise.
11. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblese.
12. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

NENI 8

ADMINISTRATORËT

Administratori i shoqerise do të jetë:

1. **Z. Luan Xhixha**, i biri i Vath -it, shtetas shqiptar, lindur në Likmetaj më 13.11.1968, banues në Likmetaj; Nd. 097; H. 00; Ap. 000; Ishëm; Likmetaj; 2015; Durrës, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar në regjistart e Gjendjes Civile me nr. personal G81113108Q.

Administratori emrohet për një afat pesë (5) vjeçare i cili fillon më datë 02.03.2021. Data e përfundimit të këtij afati është 01.03.2026.

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me shumice të thjeshtë të votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejte vote, që zoterojnë me shumë se 30 % të kuotave.

Statuti apo marreveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këto të drejte:

NENI 9

SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TË SHOQERISE

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqerise, vendoset të shperndahet nga asambleja e përgjithshme ka kompetencë t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar , që kuotat e secilit ortak perfaqesojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos t'u shperndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqerine.

NENI 10

PRISHJA E SHOQERISE, LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKËVE

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te asamblese se pergjithshme;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) Nese nuk kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr .9723 date 03.05.2007 per "QKR";
- e) Me vendim te gjykates;
- f) Per arsye te tjera, te parashikuara ne statut.

Largimi i ortakut

Ortaku mund te largohet nga shoqeria:

1. Nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij;
2. Nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij;
3. Nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

Perjashtimi i ortakut

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund t'i kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut, nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve te statutit, ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim, te parashikuara ne ligj.

NENI 11

LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.

Me vendimin e posaçem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat esecilit ortak perfaqesojne.

NENI 12

PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT

Pas shperndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombetare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

NENI 13

MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert, ortaket themelues do ti drejtohen Gjykates Rrethit Durres per zgjidhje.

Ky akt themelimi hartohet në tre (3) njësi origjinale.

ORTAKET THEMELUES

të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "L&G Sh.P.K."

1. **Luan Xhixha**

LUAN XHIXHA

